

VENDIM
Nr. 194, datë 5.4.2019

PËR KTHIM FONDI NË BUXHETIN E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të kthejë në fondin rezervë të buxhetit të shtetit shumën prej 14 561 598 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, fond i papërdorur nga fondi shtesë, i akorduar me vendimin nr. 11, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, me qëllim organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës.

2. Ky fond kalon nga zëri “Shërbime qeveritare”, i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në fondin rezervë të buxhetit të shtetit, brenda muajit prill 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama